



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 771/8 prot.

Datë 22 .04.2026

V E N D I M
Nr. 530/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22 .04.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga “Arteo 2018” sh.p.k dhe “Bregu Company” sh.p.k në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me objekt “Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit”, me nr. REF-76028-02-12-2026, fond limit 3,859,800.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 27-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec.

Anulimi i procedurës së prokurimit sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Besim Kamberi” pf, me NIPT LJ61817047D, me adresë: Rruga e Qelqit, Kashar.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Roskovec.
Adrese: Fier, Lagjia nr. 1

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Arteo 2018” sh.p.k, me NIPT L82523203F, me adresë: Lagjia Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr.303

Operatori ekonomik “Bregu Company” sh.p.k me NIPT L82729403H, me adresë: Fier, Patos, Fshati Zharrez, Bashkia Patos, Zona Kadastrale nr. 3922, Nr. Pasurie 83/209

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të 3(tre) anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5 Operatori ekonomik ankimues nuk ka plotësuar detyrimin ligjor lidhur me pagesën financiare.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 17-02-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me objekt “Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe

sportive të vitit”, me nr. REF-76028-02-12-2026, fond limit 3,859,800.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 27-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec.

II.2 Në datën 02.03.2026 autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e ofertave dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1-	“ARTEO 2018” SHPK	3,376,600	lekë	kualifikuar
2-	“Bregu Company” shpk	3,389,000	lekë	kualifikuar
3-	“Besim Kamberi” PF	3,450,450	lekë	kualifikuar

II.3 Në datën 05.03.2026 autoriteti kontraktor ka bërë publikimin e njoftimit të fituesit paraparak në SPE .

II.4. Në datën 01.04.2026 autoriteti kontraktor ka vijuar me konfirmimin e fituesit të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe me hapat e mëtejshëm.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2026/6407, datë 11.03.2026 dhe me Nr.771/2026 Prot., datë 11.03.2026 e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” PF, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomik “ARTEO 2018” SHPK dhe “Bregu Company” shpk.

II.6 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 771/1 prot., datë 12.03.2026, janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues.

II.7 Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr.771/ 2 , datë 02 .04.2026, i është drejtuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe gjithashtu informacion lidhur me veprimet procedurale lidhur me pagesën e tarifës financiare të paraqitur nga OE “Besim Kamberi” PF.

II.8 Me shkresën nr. 2667 prot., datë 09.04.2026, protokolluar me tonën 771/3 prot., datë 14.04.2026, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ku kjo e fundit lidhet me kërkesën e Komisionit te Prokurimit Publik nr. 771/ 2 , datë 02 .04.2026.

II.9 Gjithashtu Komisioni j’u drejtua sektorit përgjegjës me shkresën nr. 771/4 prot., datë 17.04.2026 lidhur më pagesën financiare nëse operatori ekonomik ka paraqitur mandat pagesë.

II.10 Lidhur me shkresën me nr. 771/4 prot., datë 17.04.2026 sektori përgjegjës ka kthyer përgjigje nga ku rezulton se operatori ekonomik nuk ka kryer pagesë për ankesën objekt ankimi.

II.11 Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” Pf mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ankimuesve nga procedura e prokurimit me arsytet:

...[A. Autoriteti Kontraktor ka shpallur si oferte të suksesshme ofertën e operatorit ekonomik Arteo 2018 në kundërshtim me ligjin pasi e ka kualifikuar duke mos përmbushur kriteret e vendosura. A/1 Konkretisht ky operator ekonomik nuk përmbush piken 2.3.1 Aftësitë teknike dhe profesionale: 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 750 000 lekë. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Duke qene se ky operator ekonomik nuk e zhvillon kete veprimtari dhe nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, kemi dyshimin e arsyeshem se nuk ka pune te ngjashme. Eshte i dyshimte fakti se mbi cilat dokumeta ky operator ekonomik e ka përmbushur kete kriter, dhe kerkojme nga KSHA te verifikoje nese punet e ngjashme jane ne perputhje me objektin e prokurimit. A/2 Gjithashtu ky operator ekonomik nuk përmbush specifikimet teknike të parashikuara nga AK. Sipas specifikimeve teknike AK ka vendosur që në ofertën e paraqitur nga operatorët ekonomik të parashikohet për zërat si më poshtë: 1. Shpërblime për fituesin, vendi i parë (volejboll): Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 16 persona × 10 000 lekë, të cilat do t’u jepen fituesve. 2. Shpërblime për vendin e dytë (volejboll): Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 16 persona × 5 000 lekë, të cilat do t’u jepen fituesve. 28. Vlerësim për konkursin “Stephanophana”: Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 100 000 lekë për personin që shpallet fitues. 29. Vlerësim – Eseja më e mirë: Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 50 000 lekë për fituesin. 30. Vlerësim – Videoja më e mirë: Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 50 000 lekë për fituesin. 36. Vlerësim për fituesit e Kupës “24 Korriku”: Vlera e pandryshuar: 15 persona

× 75 000 lekë për person. 40. Vlerësim për fituesit e vajit të ullirit: Vlera e pandryshuar: 5 000 lekë. 43. Shpërblim për fituesit (sporti): Vlera e pandryshuar: 3 persona × 10 000 lekë, si shpërblim për aktivitetin e maratonës së vrapimit. 47. Vlerësim për fituesit Vlera e pandryshuar: 13 tituj × 5 000 lekë për person. 54. Vlerësim për garuesit e “Garës me Qerre”: Vlera e pandryshuar: 2 persona × 25 000 lekë. e “Njeriut të Vitit”: Asnje nga parashikimet e mesiperme nuk janë parashikuar nga operatori ekonomik pasi vlerat e percaktuara nga AK nuk janë pasqyruar ne oferten e dorezuar. B. Autoriteti Kontraktor ka shpallur si oferte te suksesshme oferten e operatorit ekonomik Bregu Company ne kundershtrim me ligjin pasi e ka kualifikuar duke mos permbushur kriteret e vendosura. B/1 Konkretisht ky operator ekonomik nuk permbush piken 2.3.1 Aftësitë teknike dhe profesionale: 2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 750 000 lekë. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Duke qene se ky operator ekonomik nuk e zhvillon kete veprimtari dhe nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, kemi dyshimin e arsyeshem se nuk ka pune te ngjashme. Eshte i dyshimte fakti se mbi cilat dokumeta ky operator ekonomik e ka permbushur kete kriter, dhe kerkojme nga KSHA te verifikoje nese punet e ngjashme jane ne perputhje me objektin e prokurimit. B/2 Gjithashtu ky operator ekonomik nuk permbush specifikimet teknike te parashikuara nga AK. Sipas specifikimeve teknike AK ka vendosur qe ne oferten e paraqitur nga operatoret ekonomik te parashikohet per zerat si me poshte: 1. Shpërblime për fituesin, vendi i parë (volejball): Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 16 persona × 10 000 lekë, të cilat do t’u jepen fituesve. 2. Shpërblime për vendin e dytë (volejball): Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 16 persona × 5 000 lekë, të cilat do t’u jepen fituesve. 28. Vlerësim për konkursin “Stephanophana”: Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 100 000 lekë për personin që shpallet fitues. 29. Vlerësim – Eseja më e mirë: Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 50 000 lekë për fituesin. 30. Vlerësim – Videoja më e mirë: Vlera duhet të jetë e pandryshuar: 50 000 lekë për fituesin. 36. Vlerësim për fituesit e Kupës “24 Korriku”: Vlera e pandryshuar: 15 persona × 75 000 lekë për person. 40. Vlerësim për fituesit e vajit të ullirit: Vlera e pandryshuar: 5 000 lekë. 43. Shpërblim për fituesit (sporti): Vlera e pandryshuar: 3 persona × 10 000 lekë, si shpërblim për aktivitetin e maratonës së vrapimit. 47. Vlerësim për fituesit Vlera e pandryshuar: 13 tituj × 5 000 lekë për person. 54. Vlerësim për garuesit e “Garës me Qerre”: Vlera e pandryshuar: 2 persona × 25 000 lekë. e “Njeriut të Vitit”: Asnje nga parashikimet e mesiperme nuk janë parashikuar nga operatori ekonomik pasi vlerat e percaktuara nga AK nuk janë pasqyruar ne oferten e dorezuar.]

III.1.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” PF , në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe

shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përbashimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2 Në datën 17-02-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me objekt “Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit”, me nr. REF-76028-02-12-2026, fond limit 3,859,800.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 27-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec.

III.1.3 Në datën 02.03.2026 autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e ofertave dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.“ARTEO 2018” SHPK	3,376,600	lekë	kualifikuar
2.“Bregu Company” shpk	3,389,000	lekë	kualifikuar
3. “Besim Kamberi” PF	3,450,450	lekë	kualifikuar

III.1.4 Në datën 05.03.2026 autoriteti kontraktor ka bërë publikimin e njoftimit të fituesit paraprak në SPE .

III.1.5. Në datën 01.04.2026 autoriteti kontraktor ka vijuar me konfirmimin e fituesit të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe me hapat e mëtejshëm.

III.1.6. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2026/6407, datë 11.03.2026 dhe me Nr.771/2026 Prot., datë 11.03.2026 e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” PF, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomik “ARTEO 2018” SHPK dhe “Bregu Company” shpk.

III.1.7 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 771/1 prot., datë 12.03.2026, janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues.

III.1.8 Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr.771/ 2 , datë 02 .04.2026, i është drejtuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe gjithashtu informacion lidhur me

veprimet procedurale lidhur me pagesën e tarifës financiare të paraqitur nga OE “Besim Kamberi” PF.

III.1.9 Me shkresën nr. 2667 prot., datë 09.04.2026, protokolluar me tonën 771/3 prot., datë 14.04.2026, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ku kjo e fundit lidhet me kërkesën e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 771/ 2 , datë 02 .04.2026, nga ku informon se në datë 05.03.2026 është publikuar njoftimi paraprak i fituesit në SPE dhe në vijim rezulton se në datë 11.03.2026 operatori ekonomik ankimues Besim Kamberi pf ka paraqitur ankesë në sistemin elektronik pranë autoritetit kontraktor si dhe Komisionit të prokurimit publik si dhe gjithashtu më tej informon lidhur me ankesën se paraqet mangësi formale pasi nuk është e shoqëruar me mandatin pagesë.

III.1.10. Marrë shkas nga arsyeja e verifikimit të kushteve formale paraprake të ankesës të ardhur nga operatori ekonomik ankimues “Besim Kamberi” PF, si dhe referuar informacionit të ardhur nga autoriteti kontraktor, Komisioni pasi verifikoi të gjithë informacionin në dosjen administrative dhe pas komunikimit me sektorin përkatës si dhe nga përgjigja e autoritetit kontraktor lidhur me veprimet procedurale të pagesës financiare , rezultoi se autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar detyrimin ligjor për të informuar operatorin ekonomik ankimues lidhur me plotësimin e kushteve formale të ankesës, referuar parashikimeve në pikën 3,4, dhe 5 të nenit 94 VKM-së “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, përacktohet se: 3. Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkëlqes së pretenduar. Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës për llogari buxhetit të shtetit. Dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën duhet t'i bashkëlidhet ankimit, që ankimuesi do të paraqesë në autoritetin/entitetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet. 4. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementeve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandatin pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me veprimet e mësipërme, për korrigjimin e të metave të ankesës. 5. Ankesa duhet të korrigohet dhe paraqitet në autoritetin/entitetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi. Nëse ankesa nuk korrigohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur. Nëse afati i fundit bie gjatë ditëve të pushimit zyrtar, atëherë afati i fundit për plotësimin e ankesës do të jetë ditën pasardhëse të punës.

III.1.11. Referuar pikës 2, të nenit 111 të LPP-së, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3, të nenit 111 të LPP-së, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2, të nenit 111 të LPP-së. Me anë të kësaj mundësie,

ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit të subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik, thekson faktin se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga shqyrtimi i dokumenteve standarde të tenderit, përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Mos ezaurimi i momentit juridik, procedural të parshikimeve të nenit 94 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 e ndryshuar, nga autoriteti kontraktor është tregues i cili bën të ditur se autoriteti kontraktor ka dështuar të plotësojë detyrimin ligjor për plotësimin e të metave përkatësisht me mungesën e pagesës financiare për ankesën, përbën një shkelje të thellë të parimeve të ligjore dhe të transparencës që mbështetin sistemin e prokurimeve publike. Në përputhje me parashikimet në nenin 94 të VKM nr. 285, të sipërcituar, autoriteti kontraktor ka një detyrim të qartë dhe të domosdoshëm për të informuar operatorin ekonomik për çdo mangësi në dokumentacionin e paraqitur, **përfshirë atë të pagesës financiare që është një kusht esencial për pranimin dhe shqyrtimin e ankesës.** Ky detyrim ka për qëllim jo vetëm rregullshmërinë formale të procesit, por edhe mbrojtjen e të drejtave të operatorëve ekonomikë, **duke iu mundësuar atyre të korrigjojnë gabimet administrative që mund të ndodhin gjatë përgatitjes së ankesave, pa u privuar nga mundësia për të ushtruar të drejtën e tyre për një shqyrtim të plotë dhe të drejtpërdrejtë të ankesës.** Shkelja e këtij detyrimi ligjor përbën jo vetëm një mangësi procedurale administrative, por shkelje të parimeve themelore të drejtësisë, duke rrezikuar integritetin e procesit të prokurimeve publike dhe duke penguar një shqyrtim të drejtë të ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara në një procedurë prokurimi. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i Kodit të Procedurës Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtë me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike, për sa më argumentuam me sipër Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor me veprimet dhe mosveprimet e tij ka kryer shkelje procedurale duke vijuar duke mos ezauruar parashikimet e nenit 94 të VKM nr. 285, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

III.2. Gjithashtu duke vijuar më tej, Komisioni konstaton se në datën 17-02-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me objekt “Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit”, me nr. REF-76028-02-12-2026, fond limit 3,859,800.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 27-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec. Në datën 02.03.2026 autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e ofertave dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike. Në datën 05.03.2026 autoriteti kontraktor ka bërë publikimin e njoftimit të fituesit paraparak në SPE si dhe në datën 01.04.2026 autoriteti kontraktor ka vijuar me konfirmimin e fituesit të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe me hapat e mëtejshëm . Në rastin konkret, KPP referuar verifikimit të sistemit elektronik SPE rezulton se AK ka vijuar me hapat e mëtejshëm, së pari, duke mos pezulluar procedurën e prokurimit me qëllim trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Së dyti rezulton se pas verifikimeve të sistemit elektronik autoriteti kontraktor ka vijuar me hapat e e mëtejshme të procedurës si në vijim:

"Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit"		REF-76028-02-12-2026		Bashkia Roskovec E hapur, e thjesht	
Objekti i Procedurës	Krijuar në	Statusi	Perfunduar ne	Krijuar nga	Uloji i Procedures
● Kohëzgjatja dhe vlera e parashkuar	12.02.2026 14:13	Perfunduar	16.02.2026 10:26	AdminOfficer	Open_Simple
● Zyrtaret e Prokurimit	16.02.2026 10:26	Perfunduar	16.02.2026 11:24	AdminOfficer	Open_Simple
● Kriteret e Pjesemarrjes	16.02.2026 11:24	Perfunduar	16.02.2026 11:38	AdminOfficer	Open_Simple
● Kriteret e Vlerësimit	16.02.2026 11:38	Perfunduar	16.02.2026 11:48	AdminOfficer	Open_Simple
● Dokumentet e Tenderit	16.02.2026 11:48	Perfunduar	16.02.2026 12:19	AdminOfficer	Open_Simple
● Informacioni Administrativ	16.02.2026 12:19	Perfunduar	16.02.2026 12:21	AdminOfficer	Open_Simple
● Njoftimi i Kontrates	16.02.2026 12:21	Perfunduar	16.02.2026 12:24	AdminOfficer	Open_Simple
● Publikimi i Njoftimit te Kontrates	16.02.2026 12:24	Perfunduar	17.02.2026 11:32	PublishingOfficer	Open_Simple
● Dorezimi i Ofertave	17.02.2026 11:32	Perfunduar	27.02.2026 10:29	AdminOfficer	Open_Simple
● Vleresimi i Ofertave	27.02.2026 10:29	Perfunduar	02.03.2026 15:49	AdminOfficer	Open_Simple
● Kerkohet Ri-Vleresim?	02.03.2026 15:49	Perfunduar	04.03.2026 15:28	AdminOfficer	Open_Simple
● Njoftimi i Fituesit Paraprak	04.03.2026 15:28	Perfunduar	04.03.2026 15:30	AdminOfficer	Open_Simple
● Publikimi i Njoftimit te Fituesit Paraprak	04.03.2026 15:30	Perfunduar	05.03.2026 11:14	PublishingOfficer	Open_Simple
● Konfirmimi i fituesit	05.03.2026 11:14	Perfunduar	13.03.2026 13:01	AdminOfficer	Open_Simple
● Njoftimi i Fituesit Perfundimtar	13.03.2026 13:01	Perfunduar	13.03.2026 13:03	AdminOfficer	Open_Simple
● Publikimi i Njoftimit te Fituesit Perfundimtar	13.03.2026 13:03	Perfunduar	17.03.2026 11:15	PublishingOfficer	Open_Simple
● Njoftimi i Lidhjes se Kontrates	17.03.2026 11:15	Perfunduar	30.03.2026 10:17	AdminOfficer	Open_Simple
● Publikimi i Njoftimit te Lidhjes se Kontrates	30.03.2026 10:17	Perfunduar	31.03.2026 11:36	PublishingOfficer	Open_Simple
● Njoftimi i Lidhjes se Kontrates	31.03.2026 11:36	Perfunduar	31.03.2026 14:01	AdminOfficer	Open_Simple
● Publikimi i Njoftimit te Lidhjes se Kontrates	31.03.2026 14:01	Perfunduar	01.04.2026 12:01	PublishingOfficer	Open_Simple
● Konfirmim i lidhjes se kontrates	01.04.2026 12:01	Perfunduar	01.04.2026 13:46	AdminOfficer	Open_Simple
○ Arkivo Tenderin	01.04.2026 13:46	I Ri		AdminOfficer	Open_Simple

III.2.1 Referuar pikës 1 dhe 4 të nenit 114, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre. 4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”.

III.2.2. Referuar pikës 1, të nenit 100, “Afatet e shqyrtimit të ankesave nga autoriteti/enti kontraktor” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.2.3 Referuar nenit 119 “Pavlefshmëria e kontratave” të ligjit nr. 162/2020 Ligji Prokurimin publik, i ndryshuar sipas të cilit parashikohet se: *1. Një kontratë do të konsiderohet absolutisht e pavlefshme në rastet e mëposhtme: b) kur nuk janë zbatuar parashikimet e këtij ligji në lidhje me zbatimin e procedurave të ankimit, duke privuar personat e interesuar për të ushtruar të drejtën e tyre për ankim; d) Nëse një autoritet ose ent kontraktor ka nënshkruar një kontratë duke mos respektuar vendimin e dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

III.2.4 Referuar nenit 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” të ligjit nr. 162/2020 Ligji Prokurimin publik, i ndryshuar sipas të cilit parashikohet se: *3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.*

III.2.5 Referuar veprimeve dhe mosveprimeve të autoritetit kontraktor ,rezulon se autoriteti kontraktor ka kryer shkelje procedurale të cilat vijnë në kundërshtim me rekomandimin e përbashkët të Komisionit të Prokurimit Publik nr.1474 prot. Datë 11.11.2020 dhe Agjencisë së Prokurimit Publik nr.7267 prot., datë 11.11.2020 “Rekomandim mbi zbatimin e vendimeve te Komisionit të Prokurimit Publik në rastet e ankesave për modifikimin e dokumentave të procedures së prokurimit” në të cilin parashikohet se: “Në rast se një ose disa operatorë ekonomikë paraqesin ankesë pranë autoritetit kontraktor në lidhje me dokumentet e procedurës së prokurimit, në përputhje me nenin 63, pika 1.1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar dhe nenin 78 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, autoriteti kontraktor duhet të pezullojë menjëherë vijimin e procedurës, të trajtojë ankesën dhe të mbajë të pezulluar procedurën deri në përfundim të gjithë procedurave pranë KPP (në rast se paraqitet ankesë pranë këtij të fundit). Gjithashtu referuar pikës 2, të nenit 112, “Veprimet paraprake” të ligjit 162/2020 të Ligjit të Prokurimit publik, i ndryshuar përcaktohet se: “2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik”...Si dhe nenit 100 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se : “1.Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendim KPP vlerëson, se referuar parashikimeve ligjore të sipërcituara, si dhe verifikimeve të sipërpërmendura, një kontratë e cila është lidhur në kushtet e shkeljes së parashikimeve të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në lidhje kjo me zbatimin e procedurave të ankimit duke privuar personat e interesuar për të ushtruar të drejtën e tyre për ankim, si dhe gjithashtu duke mos zbatuar parashikimin ligjor, duke mos shqyrtuar fillimisht ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6407, datë 11.03.2026 dhe me Nr.771/2026 Prot., datë 11.03.2026 e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” PF, autoriteti kontraktor ka nënshkruar kontratën me operatorin ekonomik “ARTEO 2018” shpk, autoriteti kontraktor është në shkelje qartazi ligjore, të mosrespektimit të procedurës së prokurimit, pasi ka vijuar me publikimin e njoftimit të fituesit përfundimtar dhe konfirmimin e lidhjes së kontratës edhe pse për procedurën objekt shqyrtimi është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” pf, duke mos u mjaftuar me kaq, autoriteti kontraktor nuk

ka kryer dhe veprimet procedurale për plotësimin e kushteve formale të ankesës i cili është kusht esencial për vijimin e trajtimit të ankesës. Për sa më sipër Komisioni vlerëson se në kushtet ku autoriteti kontraktor ka vijuar me publikimin në datën 17.03.2026 në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) të njoftimit të fituesit përfundimtar pas afateve të ankimit, si dhe me konfirmimin e lidhjes së kontratës datë 01.04.2026 në shkelje të procedurës së prokurimit, KPP gjykon se, kontratat të cilat janë lidhur në kushte e shkeljes së parashikimeve ligjore nuk prodhojnë pasoja juridike ç'ka nënkupton se një kontratë është absolutisht e pavlefshme që në momentin e krijimit të saj, pavarësisht kushteve ose veprimeve që ndodhin më pas. Kjo do të thotë se kontrata nuk ka efekte juridike, as për palët që e kanë nënshkruar atë, pasi ka ardhur si një kontratë e lidhur në shkelje të ligjit procedural si dhe substancial dhe si e tillë nuk ka mundësi të krijojë detyrime apo të drejta për palët, ndërsa në rastin kur kontrata është realizuar atëherë Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë që të marrë një vendim deklarativ në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji. Për sa më sipër, në kushtet kur autoriteti kontraktor ka realizuar kontratën e lidhur sipas afateve të përcaktuara në kontratë dhe nisur nga fakti që kjo kontratë është lidhur në kushtet e paligjshmërisë atëherë operatori ekonomik ankimues mund ti drejtohet gjykatës sipas parashikimeve të pikës “c” nenit 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Duke vijuar më tej KPP vlerëson, se referuar parashikimeve ligjore të sipërcituara, si dhe verifikimeve të sistemit elektronik, një kontratë e cila është lidhur në kushtet e shkeljes së parashikimeve të të ligjit nr. 162/2020 Ligji Prokurimin publik, i ndryshuar, në lidhje kjo me zbatimin e procedurave të ankimit duke privuar personat e interesuar për të ushtruar të drejtën e tyre për ankim, si dhe gjithashtu duke mos zbatuar parashikimin ligjor duke mos respektuar vendimin e dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor është në shkelje qartazi ligjore, të mosrespektimit të procedurës së prokurimit, pasi ka vijuar me konfirmimin e lidhjes së kontratës edhe pse për procedurën objekt shqyrtimi është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” shpk, duke mos u mjaftuar me kaq, autoriteti kontraktor Bashkia Roskovec, ka një përgjegjësi të qartë dhe të rëndësishme të parashikuar në nenin 94 Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ai duhet të njoftojë operatorin ekonomik në lidhje me nevojën për të plotësuar çdo mangësi të mundshme, duke përfshirë atë të pagesës financiare, që është një element kyç për pranimin e ankesës. Ky detyrim nuk është thjesht një kërkesë formale, por një aspekt esencial i sigurisë juridike që duhet të sigurojë një proces të paanshëm dhe të barabartë për të gjitha palët e përfshira. Nëse ky detyrim nuk zbatohet, atëherë mund të vihen në rrezik të drejtat e operatorëve ekonomikë, duke e bërë të paqartë dhe të pasigurtë procesin e ankimit dhe shqyrtimit të ankesës e rrjedhimisht duke shmangur këtë moment procedural ose detyrim ligjor nuk zbatohet nga autoriteti kontraktor , atëherë mund të vihen në rrezik të drejtat e operatorëve ekonomikë, duke e bërë të paqartë dhe të pasigurtë procesin e ankimit dhe shqyrtimit të ankesës dhe automatikisht duke i dërguar në skualifikim nga gara e prokurimit, duke shmangur kështu në formë të drejtëpërdrejtë trajtimin e ankesës së paraqitur nga ankimuesi në shkelje kjo, e parashikuar konkretisht pika 1 dhe 4 e nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” në të cilin parashikohet shprehimisht se 1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit

Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Për sa më sipër Komisioni vlerëson se në kushtet ku autoriteti kontraktor ka vijuar më konfirmimin e lidhjes së kontratës datë 01.04.2026 në shkelje të procedurës së prokurimit KPP gjykon se, kontratat të cilat janë lidhur në kushte e shkeljes së parashikimeve ligjore nuk prodhojnë pasoja juridike ç'ka nënkupton se një kontratë është absolutisht e pavlefshme që në momentin e krijimit të saj, pavarësisht kushteve ose veprimeve që ndodhin më pas. Kjo do të thotë se kontrata nuk ka efekte juridike, as për palët që e kanë nënshkruar atë, pasi ka ardhur si një kontratë e lidhur në shkelje të ligjit procedural si dhe substancial dhe si e tillë nuk ka mundësi të krijojë detyrime apo të drejta për palët.

KPP për sa më sipër duke qenë se AK nuk ka zbatuar parashikimet ligjore të sipërcituara konsiderohet se ka kryer shkelje procedurale të cilat vijnë dhe në kundërshtim me pikën 1, nenin 100 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe pikën 2, të nenit 112, të ligjit nr. 162/2020 Ligji Prokurimit publik, i ndryshuar, duke vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës, sipas konstatimeve në pikën III.2, e në vijim të këtij vendimi.

III.3. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i Kodit të Procedurës Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

...Referuar nenit 3 pika 1 të K.Pr.A, (Ligji 44/2015) "Akti administrativ individual" është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.

...Referuar nenit 113 i Ligjit 44/2015 "Procedura dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit" K.Pr.Administrative 1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.

III. 3.1. Komisioni vlerëson se, duke marrë shkas nga konstatimi i shkeljeve ligjore të kryera në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, vëren se, autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik pasi ka mohuar të drejtat e operatorëve ekonomikë mbi ankesa në lidhje me vendimmarrjet e AK dhe shqyrtimin e tyre, ka vijuar me hapat procedural duke

mos pezulluar procedurën e prokurimit edhe pse ishte paraqitur ankesë nëpërmjet Sistemit, i cili i përcjell njëkohësisht ankesat tek Autoriteti Kontraktor dhe Komisioni i Prokurimit Publik, lidhur me procedurën objekt ankimi.

Për sa më sipër në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vijuar me konfirmimin e lidhjes së kontratës me datë 01.04.2026, në shkelje të parashikimeve ligjore duke mohuar të drejtat e operatorëve ekonomikë, Komisioni gjykon, se kontrata është absolutisht e pavlefshme që në momentin e krijimit të saj, pavarësisht kushteve ose veprimeve që ndodhin më pas. Kjo do të thotë se kontrata nuk ka efekte juridike, as për palët që e kanë nënshkruar atë, pasi ka ardhur si një kontratë e lidhur në shkelje të ligjit procedural si dhe substancial dhe si e tillë nuk ka mundësi të krijojë detyrime apo të drejta për palët.

Për sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të anullojë procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi në kushtet e shkeljeve të ligjit procedural dhe substancial të sipërcituara në vendim.

II.3.2. Në nenin 131 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se:”1. Refuzimi i autoritetit ose entit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Agjencinë e Prokurimit Publik ose moszbatimi brenda afatit i vendimeve të këtyre të fundit në mënyrë të pajustificuar ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.” 2. Masa e gjobës vendoset në raport me vlerën e përlllogaritur të kontratës dhe sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”. Në këtë kuptim, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me anë të veprimeve dhe mosveprimeve, autoriteti kontraktor ka kryer shkelje procedurale dhe substanciale në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” pf, në kuptim të nenit 114 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në vijim të faktit se ka vijuar me hapa të mëtëjshëm të reflektuara në pikën III.2 e në vijim, si dhe III.1.10 e në vijim të këtij vendimi.

III.3.3. Sa më sipër, duke marrë në konsideratë faktin se titullari i autoritetit kontraktor nuk është përsëritës në shkeljen administrative pavarësisht natyrës dhe volumit të kontratave të procedurave të prokurimit, në mbështetje të nenit 24 dhe 131 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Ligjit Nr. 10279 datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të marrë masën administrative gjobë në masën 100,000 (qind mijë) lekë për Znj. Majlinda Bufi, Titullar i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Roskovec.

III.3.4 Komisioni i Prokurimit Publik në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik, nisjen e hetimit administrativ për zyrtarët përgjegjës për shkeljet e konstatuara.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 24 e në vijim të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Ligjit Nr. 10279 datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” pf për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me objekt “Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit”, me nr. REF-76028-02-12-2026, fond limit 3,859,800.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 27-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me objekt “Shpenzime për aktivitete social-kulturore dhe sportive të vitit”, me nr. REF-76028-02-12-2026, fond limit 3,859,800.00 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 27-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Roskovec.
3. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 (pesë) ditëve duke dokumentuar çdo veprim të tij.
4. Operatori ekonomik ankimues “Besim Kamberi” pf të zbatojë parashikimet e pikës 3/c të nenit 118 “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
5. Të marrë masën administrative gjobë në masën 100,000 (qind mijë) lekë për Znj. Majlinda Bufi, Titullar i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Roskovec.
6. Kjo gjobë përbën titull ekzekutiv.
7. Kundër vendimit për marrjen e masës administrative (gjobë) mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, në përputhje me Ligjin nr. 10279 datë 20.5.2009 “Për kundërvajtjet administrative”.
8. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në shqyrtimin administrativ nr. 771 prot., datë 11.03.2026.
10. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Monitorimit Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror.

11. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

